



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME E NDËRTIMIT "KARL GEGA" TIRANË

Nr. 53 Prot.

Tiranë, më 06 /02/2025

Lënda : Njoftim për vend të lirë pune

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore
DREJTORISË E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit Nr.15 datë 16.02.2017 , "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", VKM nr 554 date 31.07.2019 " Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punesimit dhe Aftësive (AKPA) , Udhëzimit të MFE, Nr.25, datë 01.09.2023 nr 15702 prot "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet arsimit profesional" Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Nr.759, datë 30.09.2024 "PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË, MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJEN E NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONEVE, OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT" , neni 135 dhe 136 pika 3 , ofruesi publik i AFP-së, Shkolla e mesme e ndërtimit "Karl Gega", ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

1- Përgjegjës i sektorit të financës dhe administrimit – 1 (Një)

Aplikanti duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteria të posaçme për përgjegjësin e sektorit të financës dhe administrimit:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “Master i shkencave” (ose të barasvlershme), në shkencë ekonomike;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë në profesion, sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

3. Dokumentet e aplikimit Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda afateve të aplikimit të përcaktuara në shpallje 19 /02/2025.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

Konceptoi: A. Myrtja

Pranoi: I. Gorçe

Miratoi: I. Gorçe

Konfirmoi: I. Gorçe

